



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 197

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 29 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Konstatim i shpërdorimit të burimeve publike nëpërmjet shitblerjes së votës së zgjedhësve

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 29 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon: *“Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet publikimeve në media, se në Britaninë e Madhe ka filluar blerja e votave nga emigrantë shqiptarë. Në media janë publikuar artikuj ku tregohet se si individë të cilët kanë hapur edhe zyrën e PS-së në Britani, kanë filluar të marrin në telefon emigrantët shqiptarë, duke i ofruar nga 50 paund në këmbimtë votës për Edi Ramën”.*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

Data 25.02.2025

Nr: 197
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 29 ID, datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mos fillimin e procedurës administrative të denoncimit nr. 29, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI